



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 926/1 prot.

Tiranë, më 30. 06. 2021

V E N D I M

Nr. 122, datë 30. 06. 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 116, datë 17.06.2021, të paraqitur nga A. D., kundër Shoqërisë Imobiliare Remax sh.p.k., në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të moshës*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, më datë 27.05.2021, është vënë në dijeni të shpalljes së një pozicioni vakant pune si Konsulent Imobiliar, nga Shoqëria Remax sh.p.k., për të cilin ka paraqitur aplikimin e saj on-line. Në vijim, ka marrë një telefonatë nga një person i cili i është prezantuar si menaxhere e Remax sh.p.k. dhe gjatë bisedës telefonike, ankuesja pretendon se sapo punonjësja e Remax sh.p.k. është vënë në dijeni të moshës së saj, ka ndërprerë telefonatën duke mos i dhënë asnjë sqarim.

Sipas ankueses, ajo e ka telefonuar sërish punonjësën e Remax sh.p.k., për të marrë informacion lidhur me arsyen e ndërprerjes së telefonatës sapo ajo ka cituar moshën e saj, por nuk ka arritur të kontaktojë pasi nuk i është hapur telefoni nga përfaqësuesja e shoqërisë.

Në këto kushte, ankuesja ka dërguar një mesazh të shkruar (sms) drejtë numrit të telefonit të punonjësës së Remax sh.p.k. dhe më pas një e-mail zyrtar në adresën e shoqërisë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje lidhur me to.

Referuar situatës së sipërcituar, ankuesja pretendon se është diskriminuar nga ana e Shoqërisë Remax sh.p.k., për shkak të moshës së saj.

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin e saj nga ana e Shoqërisë Remax sh.p.k.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7/1 i LMD-së¹, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në vijim, ankuesja me datë 29.06.2021, me anë të e-mailit, ka paraqitur pranë institucionit të Komisionerit një kërkesë për tërheqjen e ankesës dhe pushimin e saj.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

¹ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga A. D., e cila me anë të kërkesës, datë 29.06.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 116, datë 17.06.2021, paraqitur nga A. D. kundër Shoqërisë Imobiliare Remax sh.p.k., për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Moshë)
(Fusha: Punësim)